4. Nëse, Autoriteti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

EKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës Ekonomike në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafiku i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Loti 1 –Veshje, uniforma policia (Policia Bashkiake)

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	6	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (4 x 5)	
	<i>Uniforma verore</i>					
1.	<i>Bluze verore</i>	<i>Copë</i>	<i>54</i>			
2.	<i>Pantallona verore</i>	<i>Copë</i>	<i>54</i>			
3.	<i>Këpucë verore</i>	<i>Palë</i>	<i>54</i>			
4	<i>Kapele</i>	<i>Copë</i>	<i>54</i>			
5	<i>Shenja dalluese Supi</i>	<i>Copë</i>	<i>54</i>			
6	<i>Shenja dalluese Krah</i>	<i>Copë</i>	<i>54</i>			

7	<i>Shenja dalluese Gjoksi</i>	<i>Copë</i>	<i>54</i>			
8	<i>Rrip mesi</i>	<i>Copë</i>	<i>18</i>			
9	<i>Jelek fosforeshent</i>	<i>Copë</i>	<i>54</i>			
	<i>Uniforma Dimërore</i>					
10	<i>Xhaketë ceremoniale</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>			
11	<i>Pantallona ceremoniale</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>			
12	<i>Këmishë ceremoniale</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>			
13	<i>Kapele ceremoniale</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>			
14	<i>Shirita të gërshetur</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>			
15	<i>Këpucë uniforme</i>	<i>Palë</i>	<i>4</i>			
16	<i>Doreza uniforme</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>			
17	<i>Rrip mesi, rrip krahëqafë</i>	<i>Copë</i>	<i>4</i>			
18	<i>Pantallona dimërore</i>	<i>Palë</i>	<i>54</i>			
19	<i>Bluzë me mëngë të gjata</i>	<i>Copë</i>	<i>54</i>			
20	<i>Xhup</i>	<i>Copë</i>	<i>36</i>			
21	<i>Këpucë me qafë</i>	<i>Copë</i>	<i>54</i>			
22	<i>Bluzë e brëndshme</i>	<i>Copë</i>	<i>54</i>			
23	<i>Pelerina shiu</i>	<i>Copë</i>	<i>36</i>			
24	<i>Doreza lëkure</i>	<i>Copë</i>	<i>36</i>			
		Çmimi total (Mallrat)				_____
	Çmimi Neto pa TVSH					

	TVSH (%)	
	Çmimi total me TVSH:	
	Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
	Vula	
	Datë _____	

Loti 2 - "Veshje dhe uniforma per parkimin me pagese"

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	6	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (4 x 5)	
1.	Xhup pa mëngë (puffer vest)	Copë	36			
2.	Bluza me mëngë të shkurtra	Copë	36			
		Çmimi total (Mallrat)				_____
	Çmimi Neto pa TVSH					
	TVSH (%)					
	Çmimi total me TVSH:					

	Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
	Vula	
	Data _____	

Loti 3 - "Uniforma pune MZSH"

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	6	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (4 x 5)	
1.	Xhup treçerek dimëror	Copë	29			
2.	Këpucë me qafë	Palë	4			

3.	Pulovër me jakë "V"	Copë	4			
4.	Kostum pune vere dok (xhaketë, pantallona, kapele)	Copë	26			
5.	Kostum pune dimri (xhaketë, pantallona, kapele)	Copë	26			
6.	Këpucë verore	Palë	30			
7.	Këpucë dimërore	Palë	30			
8.	Rripa pantallonash	Copë	33			
9.	Bluza me mëngë të gjata pambuku (jaka sportive)	Copë	66			
10.	Bluza me mëngë të shkurtra pambuku (jaka sportive)	Copë	8			
11.	Çorape	Palë	165			
12.	Këmishë me mëngë të shkurtra	Copë	8			
13.	Kravata	Copë	4			
14.	Këmishë me mëngë të gjata	Copë	8			
		Çmimi total (Mallrat)				_____
	Çmimi Neto pa TVSH					
	TVSH (%)					
	Çmimi total me TVSH:					
	Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi					
	Vula					
	Data _____					

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Loti 1 –Veshje, uniforma policia (Policia Bashkiake)

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike për artikujt e objektit “**Veshje, uniforma policia (Policia Bashkiake)**”, për uniformat e policisë bashkiake, janë të bazuar tek VKM nr.494, datë 24.08.2023 “*Për miratimin e Uniformës, Shenjave dalluese dhe Modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake*”.

VESSHJE, UNIFORMA POLICIA (POLICIA BASHKIAKE)**- UNIFORMA VERORE**

Nr	Artikulli	Përshkrimi i detajuar
1	Bluzë verore	• Bluzë me mëngë të shkurtra e trikotuar, e hapur në mes dhe mbyllet përpara me tri kopsa të vogla (model polo). • Pjesa poshtme është ngjyrë blu e errët së bashku me jakën, ndërsa pjesa e sipërme e kaltër. • Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë, ndërsa përpara në krahun e djathtë sipër, vendoset shenja e gjoksit dhe poshtë saj mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”. Mbishkrim është edhe në pjesën prapa në shpatullat dhe duhet të jetë i qëndisur në të dyja anët e bluzës jo e stampuar. • Bluza për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra në krahun e majtë.
2	Pantallona verore	• Pantallonat do të jenë ngjyrë blu e errët, te pajisura me dy xhepa të përparme diagonal dhe me një xhep të pasëm. • Konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik, me vijë hekurosjeje. • Materiali të jetë material i derdhur i përshtatshëm për stinën e verës, me përzjerje 33% pambuk dhe 67% poliestër.
3	Këpucë verore	• Këpucët të jenë ngjyrë të zezë, gjysma, me lidhëse për punonjësit meshkuj dhe punonjëset femra. • Materiali i këpucëve të jetë i përshtatshëm për stinën e verës dhe i rehatshëm.
4	Kapele	• Kapele blu e errët, me stemën e bashkisë në qendër dhe me mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”. Mbyllja e kapeles në pjesën e mbrapshme të jetë me ngjitje (grifsha). Kapelja është e njëjtë për femrat, ku modeli është ai që do i dallojë.
5	Shenja dalluese	• Shenja e gjoksit vendoset në gjoks në krahun e djathtë. Është në formë drejtkëndëshi dhe brenda saj vendoset stema e bashkisë dhe numri personal. Numrat personalë do nisin nga 001 deri 016. • Shenja e krahut është në formë mburoje dhe përmban stemën e bashkisë dhe mbi të mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”. Kjo shenjë vendoset në krahun e majtë dhe është e njëjtë për drejtuesin, dhe punonjësin e Policisë Bashkiake. • Shenjat e supit ngjyrë blu të errët është në formë spaleti. Kjo shenjë ka elementin dallues të stemës së bashkisë, shoqëruar me shirita. Shenja me tre shirita ngjyrë ari për drejtorin dhe me një shirit të kaltër për punonjësin. • Shenjat dalluese, do të jenë nga dy për secilën pjesë (Gjoks, Nr. Personal dhe Supi).

6	Rrip mesi	Me tokëz metalike katrore. Gjatësia dhe gjërësia të jenë standarte.
7	Jelek fosforeshent	- Jelek fosforeshent. me ngjyrë të verdhë me dy shirita të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati, të paisur me dy xhepa përpara tek pjesa e barkut . - Shiritat janë të vendosur horizontalisht. Në pjesën përpara në krahun e majtë vendoset mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”, në krahun e djathtë vendoset shenja e gjoksit.

VESSHJE, UNIFORMA POLICIA (POLICIA BASHKIAKE)

- UNIFORMA DIMËRORE

Nr.	Artikulli	Përshkrimi i detajuar
1.	Xhakete ceremoniale	- Xhaketa ceremoniale te jenë blu e errët, me spaleta për vendosjen e shenjave të supit dhe katër kopsa. Ka katër xhepa me kapak(dy xhepa të vegjël në pjesën e gjoksit dhe dy xhepa të mëdhenj të poshtëm). Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë.Te jaka vendoset elementi kryesor i stemës së bashkisë. - Xhaketa e uniformës për femra është e njëjtë përveç modelit, i cili duhet të jetë për femra, me kopsat në anën e majtë.
2.	Pantallona ceremoniale	- Pantallona ceremoniale ngjyrë blu e errët . - Pantallonat duhet të paisen me dy xhepa të përparëm diagonal dhe me një xhep të pasëm. - Konstruksioni i pantallonës për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. - Pantallonat për femra kanë konstruksion të njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra.
3.	Këmishë ceremoniale	- Këmishë ceremoniale me mengë të gjata , ngjyrë e kaltër. - Këmisha në pjesën e supeve ka dy spaleta për montimin e shenjave të supit. - Mbyllja e këmishës bëhet me shtatë kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë,në krahun e djathtë sipër vendoset stema e gjoksit. - Këmisha për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë. - Për drejtuesin këmisha ka elementë të njëjta dhe me ngjyrë të bardhë.
4.	Kapele ceremoniale	- Kapele ceremoniale bliu e errët, me stemën e bashkisë në qendër, shoqëruar me shirit të gërshetuar përpara. - Shiriti ngjyrë ari është për drejtuesin, shiriti ngjyrë argjende për përgjegjës të sektorit dhe shiriti ngjyrë e kaltër për punonjës. - Kapela ka strehë plastike me ngjyrë të zezë.
5.	Shirita të gërshetuar	- Shirita janë të gërshetuar. - Shiriti ngjyrë ari është për drejtuesin, shiriti ngjyrë argjende për përgjegjës të sektorit dhe shiriti ngjyrë e kaltër për punonjës.
6.	Këpucë uniforme	Këpucë uniforme të jenë ngjyrë e zezë dhe me lidhëse.

7.	Doreza uniforme	Doreza uniforme ngjyrë të bardhë.
8.	Rrip mesi, rrip krahëqafë	Rrip mesi, rrip krahëqafë ngjyrë e bardhë, tokëz metalike katrore me stemën e bashkisë.
9.	Pantallona	- Pantallonat të jenë blu e errët, të paisura me dy xhepa të përparëm diagonal , me një xhep të pasëm dhe xhepa anësore për secilin krah (model cargo). - Pantallonat për femra kane konstruksion të njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra. - Materiali të jetë i përshtatshëm për stinën e dimrit, me përzierje pambuk dhe poliestër
10.	Bluzë me mëngë të gjata	- Bluzë me mëngë të gjata ngjyrë blu e errët, e trikotuar, e hapur në mes dhe mbyllet përpara me tri kopsa të vogla (model polo). - Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë, ndërsa përpara në krahun e djathtë sipër, vendoset shenja e gjoksit. - Bluza për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë. - Material të jetë i përshtatshëm për stinën e dimrit.
11.	Xhup	- Xhup blu i errët në pjesën poshtë, shoqërohet me shirita të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. - Pjesa e sipërme është ngjyrë e kaltër. - Mëngët janë ngjyrë blu e errët së bashku me jakën. - Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë dhe në krahun e djathtë, poshtë shiritit shenja e gjokst. - Në pjesën e pasme vendoset mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”.
12.	Këpucë me qafë	- Këpucët me qafë ngjyrë e zezë, me lidhëse. Këto shërbejnë edhe për stërvitje. - Materiali i këpucëve të jetë i përshtatshëm për stinën e dimrit me push nga brenda dhe i rehatshëm.
13.	Bluzë e brendshme	- Bluzë e brendshme dimri pambuk me jakë rrethore. - Në pjesën përpara në anën e majtë sipër, vendoset stema e bashkisë dhe në pjesën prapa do të ketë mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”. Ky model shërben edhe për stërvitje.
14.	Pelerina shiu	- Pelerina e shiut është me ngjyrë të zezë. Në pjesën e përpara në anën e majtë sipër, ka stemën e bashkisë dhe në pjesën prapa do të ketë mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”. - Pelerina e shiut duhet të ketë prerje pardesyje, e padepëerushme nga uji, era dhe më kopsa të lëvizshëm
15.	Doreza lëkure	Dorezat të jenë lëkure me ngjyrë të zezë.

--	--	--

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Afati i lëvrimit: 30 dite kalendarike nga data e lidhjes te kontrates

Shënim: Shoqëria fituese përpara prodhimit duhet të kryejë marrjen e përmasave për secilin person.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ne ofertat e tyre mallrat e kerkuara sipas standartit të kerkuar si me sipër.

Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.

Loti 2 - Veshje uniforma, punonjesit e parkimit me pagese

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

VESHJE UNIFORMA, PUNONJESIT E PARKIMIT ME PAGESE

1. XHUP PA MENGË (PUFFER VEST)

-
- Xhup pa mëngë blu i errët me jakën.
 - Në pjesën e pasme në mes, vendoset mbishkrimi: “Parkimi me Pagesë”
 - Në pjesën e majtë sipër, vendoset mbishkrimi: “Parkimi me Pagesë”.
 - Material i plotë i përshtatshëm për stinën e dimrit.

2. BLUZA ME MENGE TË SHKURTRA

- Bluza me minge të shkurtra e trikotuar me jakë rrethore material i përshtatshëm për stinën e verës.
- Në pjesën përpara në anën e majtë sipër, vendoset mbishkrimi “Parkimi me Pagesë” dhe në pjesën e pasme tek shpatullat mbishkrimi “Parkimi me Pagesë”.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Afati i lëvrimit: 30 dite kalendarike nga data e lidhjes te kontrates

Shënim: Shoqëria fituese përpara prodhimit duhet të kryejë marrjen e përmasave për secilin person.

Operatorët ekonomike janë të detyruar të paraqesin në ofertat e tyre mallrat e kerkuara sipas standartit të kerkuar si me sipër.

Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.

Loti 3 - “Uniforma pune MZSH”

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk

ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

UNIFORMA PUNE(DREJTORIA E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPETIMIT)

Specifikimet jane hartuar ne perputhje me *V.K.M. nr.1153 dt. 24.12.2020 (“Per miratimin e uniformes, shenjave dalluese perkatese, flamurit dhe stemes se sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit”*, Lidhja nr.01, Lidhja nr.02 duke zbatuar normat perkatëse mbi afatet sipas cdo artikulli.



1. XHUP TREÇEREKSH DIMËROR

Xhupi ka shtresë të brendshme dhe është me ngjyrë blu të errët. Ështëkonfeksionuar në 8 prerje(XS–S–M– L–XL–XXL–XXXL–4XL).

Prej pjesës së kraharorit deri te lartësia e gjoksit dhe përmes shpinës është e përforcuar dhe ka shtresën e brendshme që arrin deri te fundi i mëngës.

Në pjesën e poshtme të xhupit nga të dy anët janë të vendosura dy xhepa të thellë me kapakë.

Xhupi është me gjatësinë e duhur/të përshtatshme dhe arrin deri mbi gjunjët.

PËRSHKRIMI- KONSTRUKTIMI

Xhupitreçerekshështë realizuar me tekstil, me ngjyrë blu dhe përbëhet nga këto elemente:

-përpara (me dy pjesë, gjokset);

-shpina (pjesa pas);

-jaka;

-dy spaleta;

-dy mëngë;

-një shtresë e brendshme.

Jaka	Realizuar model korean me lartësi rreth 7,5 cm. Mbyllja dhe hapja e saj kryhet me anë të zinxhirit me ngjyrë blu në tonalitet me tekstin e xhupit.
------	--

Përpara	Dy pjesët përpara bashkohen ndërmjet tyre përgjatë linjës qendrore në të gjithë gjatësinë e tij me anë të një zinxhiri tip 8 dhëmbësh, anët e të cilit mbulohen nga jashtë me anë të një mostre të realizuar me tekstil dopio me gjerësi rreth 5 cm. Linja fundore e xhupit përpara, përfundon me një kthim pale (tegel njëgjilpërësh).
Xhepat	Xhupi ka katër xhepa me kapakë, të pozicionuar përkatësisht: dy xhepa në lartësinë e gjoksit dhe xhepat e poshtëm të pozicionuar përgjatë linjës së belit. Kapakët janë realizuar me tekstil dopio të përforcuar me frazelinë ndërmjet dy shtresave të tekstit në brendësi dhe përfundojnë me kulme. Hapja dhe mbyllja e xhepave me kapakët realizohet me anë të velkrofëve “mashkull” – “femër”, të aplikuar në pjesën e brendshme të kapakëve, në korrespondencë me velkrofët e montuar në xhepa.
Shpina	Është realizuar me një pjesë. Bashkohet me pjesët e tjera në gavaturë (rreth mënge) me anë të syzatorit, ndërsa në pjesët përpara në anësor me tegel linear. Linja fundore e xhupit pas përfundon me një kthim pale (tegel njëgjilpërësh).
Mëngët	Mëngët janë realizuar me dy pjesë: një mëngë e sipërme dhe një mëngë e poshtme. Mëngët bashkohen me trupin e xhupit me anë të syzatorit dhe tegelit linear njëgjilpërësh. Dy mëngët përfundojnë në linjën fundore me një palosje të brendshme me lartësi rreth 2 cm. Pjesa fundore e mëngës paraqet, në tegelin qepës të poshtëm në të dy pjesët përbërëse të saj, një gjuhëz, baza e të cilës është montuar në tegelin qepës. Tre drejtimet e tjera janë përshkruar me tegel linear perimetral njëgjilpërësh nga bordet. Në pjesën e poshtme të gjuhëzës është aplikuar një velkrof “mashkull”, në korrespondencë me të, në fund të mëngës, është montuar në drejtim horizontal një shirit velkrofi “femër”. Gjuhëza bën të mundur rregullimin e linjës fundore të mëngës për përshtatje të perimetrit të kyçit të dorës.
Spaletat	Spaletat janë montuar në linjën e supeve. Janë realizuar me dy shtresa tekstili, në formë drejtkëndore fundi i lirë i të cilave përfundon me kulm me majë. Baza (ana drejtkëndore e spaletave) montohet në rrethin e mëngës. Në skajin e lirë, me kulm me majë, të pjesës së poshtme të spaletës, është aplikuar një shirit velkrofi “femër” në formë drejtkëndor. Në korrespondencë me të është aplikuar një velkrof “mashkull”, të cilat bëjnë të mundur fiksimin e spaletës.

Pjesa e brendshme	Në brendësi të xhupit është aplikuar një “xhup” i brendshëm i realizuar me një shtresë me mbushje me vatinë, e cila është aplikuar ndërmjet dy shtresave të tekstilit 100% poliestër (astar) të realizuar me tegela në formë romboidale. Pjesa e brendshme përbëhet nga: jaka, dy pjesët përpara, shpina, mëngët.
Etiketa	Në pjesën e brendshme të xhupit treçereksh në lartësinë e jakës në pjesën e prapmejanë aplikuar etiketat e mëposhtme: - etiketa me demonstrimin e firmës furnizuese; - etiketa me udhëzimet e prerjes; - treguesi i përbërjes së tekstilit me vitin e fabrikimit, si dhe instruksionete larjes; - mirëmbajtja.



2. KEPUCE ME QAFE

1. FAQE KËPUCE

Faqet e këpucës janë realizuar me pjesë të cilat bashkohen ndërmjet tyre me anë të tegelit qepës. Lëkura e përdorur duhet të jetë e një cilësie të mirë, e marrë nga pjesët më të mira, e trajtuar me krom, me ngjyrë të zezë me trashësi rreth 1,8–2mm. Faqet kambale janë përshkuar si nga tegela bashkues qepës perimetral, ashtu

dhe me tegela për efekt estetik. Në dy faqet kambale, në lartësinë e qafës së këpucës, janë aplikuar katër vrima

me veshje hekuri të cilat shërbejnë për mbylljen e këpucës nëpërmjet lidhëseve tubolare prej pambuku. Faqja

e përparme bashkohet me trupin e faqeve me tegel qepës zbukurues dhe përfundon në afërsi të qafës së këpucës me aplikimin e një llape e cila është e përforcuar me anë të tegelit qepës syzator dhe montuar me anë të tegelit qepës perimetral.

Faqet bashkohen me shtrojën, xhiron rrethuese dhe shollën nëpërmjet procesit të ngjitjes.

2. MAJA

Është realizuar nga material prej pambuku të presuar me ngjitës me bazë laktike, me trashësi rreth 0,8mm, aplikuar në pjesën e përparme nga brenda këpucës ndërmjet astarit dhe faqes së sipërme të këpucës.

3. PËRFORCUES I BRENDSHËM

I realizuar prej materiali sintetik në brendësidhenë anën e pasme ndërmjet faqes së sipërme dhe astarit të brendshëm.

4. ASTARI I BRENDSHËM

Pjesa e brendshme e këpucës: llapa, faqet kambale dhe thembra janë realizuar me astar prej lëkure të butë.

5. THEMBRA

Është realizuar me material lëkurë me trashësi rreth 2mm, e pozicionuar në pjesën mbështetëse të thembrës,

në pjesën e poshtme të së cilës është aplikuar një shtresë sfungjeri amortizuese. Thembra bashkohet me shtrojënme anë të procesit të ngjitjes.

6. SHTROJA

Është e realizuar me material shumë shtresor me anë të procesit të ngjitjes dhe është e përbërë nga:

-texon (karton kompakt);

-lamin;

-kambrion (karton i presuar);

-taban prej lëkure;

-gjysmë shtroje prej lëkure derri e trajtuar me krom.

7. SHOLLA PREJ GOME

Është realizuar me material gome, dhe bashkohetme tabanin nëpërmjet ngjitjes. Pjesa fundore e këpucës përfundon me një dizejnim me vijëzime me dimensione të ndryshme për funksion anti rrëshqitës.

AKSESORËT

Filli– për faqet e këpucës përdoret fill qepës me përbërje 100% poliamid;

Thumbat – prej hekuri të përdorur për montimin e thembrës;

Ngjitësit – duhet të jenë të llojit dhe të cilësisë nga më të mirët në treg, jo

dëmtues dhe të përshtatshëm në përdorim;

Lidhëset – duhet të jenë prej pambuku të mercerizuar të tipit tub me ngjyrë

të zezë, që nuk krijojnë nyje me ekstremet plastike.



3. PULOVER ME JAKE “V”

Pulovra duhet të realizohet me tekstil trikotazh, me ngjyrë blu të errët, me material, me jakë “V”.

I. KONSTRUKTIMI I PULOVRES JAKË “V”

-Pulovra përbëhet nga jaka në formë V-je, mëngët, shpina, gjoksi, spalinat dhe fortesat dok trikoton në ngjyrë blu të errët në sup dhe në bërryl;

-Linja fundore e mëngëve dhe e pulovrës përfundon me bordurë methurje llastik për përshtatje dhe qëndrim të formës sipas perimetrave;

-Në krahun e majtë lart vendoset stema e rrumbullakët me shkronja kapitale “MZSH”;

-Sipër në gjoksin e djathtë vendoset velkrof “femër” në formë drejtkëndëshi me ngjyrë blu të errët;

-Jaka në formë V-je, mëngët, shpina dhe gjoksi janë të përgatitura me anë të procesit të trikotimit;

-Spalinat janë me maja të harkuara dhe vendosen në të dy supet;

-Spalina përbëhet nga pjesa e sipërme dhe e poshtme. Pjesës së sipërme të spalines për përforcim i vendoset

kollaritje (material tekstili ngjitës);

-Spalina ka gjatësia 13,7cm dhe gjerësi 5 cm; spalinës 5mm larg buzëve i kalohet një tegel zbukurimi;

-Spalinat duhen të shohin lart, si dhe spalinave sipër në majë iu vendoset velkrof “femër” në ngjyrë blu të errët dhe nga poshtë velkrof “mashkull” në ngjyrë blu të errët për fiksime te supi me velkrofin “femër” korrespondues të vendosur në sup.

II. MATERIALET NDIHMËSE QË DUHET TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN E ARTIKULLIT

“PULOVËR” JANË:

-Dok trikoton me ngjyrë blu të errët;

-Fill qepës me ngjyrë blu të errët;

-Velkrofe femër me ngjyrë blu të errët;

III. TABELA E MASAVE

(përmasat e shprehura në cm – tolerancë +/- 3%)

4. KOSTUM PUNE VERE DOK TRIKOTON (XHAKETA, PANTALLONI, KAPELA)

Kostum pune vere, materiali duhet të jetë dok, ngjyra blu e errët, e qepur me blu e cila përmban (xhakëtë, pantallona dhe kapele).

XHAKETA

Materialet ndihmëse që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Xhakëtë” janë:

-Dok trikoton;

-Penj qepje, blu e errët me ngjyrën e dokut;

-Velkrofe “femër” me ngjyrë blu të errët.

Artikulli xhakëtë “Kostum pune vere” prodhohet në bazë të gjatësive trupore dhe porositet nga përdoruesi në sasi të përkatëse sipas numrave të gjokseve, të cilat subjekti prodhues është i detyruar t’i respektojë saktësisht.

Përmasat e duhura të elementeve, të cilat bëjnë pjesë në ndërtimin e artikullit “Kostum pune vere”, janë:

-Xhaketa përbëhet nga jaka, shpina, mëngët, gjokset, dorezat e mëngëve, bordura përpara, xhepat e poshtëm

anash, sipër në gjoksin e majtë vendoset velkrof “femër” në formë drejtkëndëshi me ngjyrë të zezë, bordura

e poshtme dhe astari i brendshëm, shirita fosforeshente te krahu i majtë e i djathtë, shirit fosforeshent te gjoksi sipër dhe shiriti fosforeshent është te pjesa fundore e xhupit.

-Gjoksi i majtë dhe i djathtë përpara ka një shirit fosforeshent në ngjyrë gri metalizato me përmasa 6cm të gjerë, të cilës në të dy anët gjatë gjithë gjatësisë i kalohen tegelat e zbukurimit 5mm larg buzëve. Në anën e

majtë të kraharorit vendoset xhepi i kraharorit për radio 15x3cm. Sipër xhepit të radios vendoset velkrof në

ngjyrë blu për vendosjen e shenjës së emrit.

-Shpina mbrapa në pjesën e sipërme do të vendoset një shirit me përmasa në lartësi 15cm, dhe gjerësi sa ajo

ndërmjet gaturave. Ngjyra e shiritit do të jetë gri metalizato, mbitë cilën do të shkruhet me shkronja shtypi

“ZJARRFIKËS”. Shkrimi do të jetë ngjyrë blu e errët.

PANTALLONAT

Pantallonat janë me ngjyrë blu të errët, me prerje të gjerë, me përbërje të njëjtë si xhaketa;

Në pjesën e sipërme, në anën e majtë dhe të djathtë, kanë nga një xhep me prerje të pjerrtë;

Në anën e majtë dhe në anën e djathtë, në lartësinë mbi gjunjë, janë të qepur dy xhepa në formë harmonike

me kapakë, të cilët mbërthehen me ngjitëse.

5.KOSTUM PUNE DIMRI TRIKOTON (XHAKETA, PANTALLONI, KAPELA

Kostum pune vere, materiali duhet të jetë dok, ngjyra blu e errët, e qepur me blu e cila përmban (xhakëtë, pantallona dhe kapele).

XHAKETA

Materialet ndihmëse që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Xhakëtë” janë:

-Dok trikoton;

-Penj qepje, blu e errët me ngjyrën e dokut;

-Velkrofe “femër” me ngjyrë blu të errët.

Artikulli xhakete “Kostum pune vere” prodhohet në bazë të gjatësive trupore dhe porositet nga përdoruesi në sasi të përkatëse sipas numrave të gjokseve, të cilat subjekti prodhues është i detyruar t’i respektojë saktësisht.

Përmasat e duhura të elementeve, të cilat bëjnë pjesë në ndërtimin e artikullit “Kostum pune vere”, janë:

-Xhaketa përbëhet nga jaka, shpina, mëngët, gjokset, dorezat e mëngëve, bordura përpara, xhepat e poshtëm anash, sipër në gjoksin e majtë vendoset velkrof “femër” në formë drejtkëndëshi me ngjyrë të zezë, bordura e poshtme dhe astari i brendshëm, shirita fosforeshente te krahu i majtë e i djathtë, shirit fosforeshent te gjoksi sipër dhe shiriti fosforeshent është te pjesa fundore e xhupit.

-Gjoksi i majtë dhe i djathtë përpara ka një shirit fosforeshent në ngjyrë gri metalizato me përmasa 6cm të gjerë, të cilës në të dy anët gjatë gjithë gjatësisë i kalohen tegelat e zbulurimit 5mm larg buzëve. Në anën e majtë të krahorit vendoset xhepi i krahorit për radio 15x3cm. Sipër xhepit të radios vendoset velkrof në ngjyrë blu për vendosjen e shenjës së emrit.

-Shpina mbrapa në pjesën e sipërme do të vendoset një shirit me përmasa në lartësi 15cm, dhe gjerësi sa ajo ndërmjet gavaturave. Ngjyra e shiritit do të jetë gri metalizato, mbitë cilën do të shkruhet me shkronja shtypi “ZJARRFIKËS”. Shkrimi do të jetë ngjyrë blu e errët.

PANTALLONAT

Pantallonat janë me ngjyrë blu të errët, me prerje të gjerë, me përbërje të njëjtë si xhaketa;

Në pjesën e sipërme, në anën e majtë dhe të djathtë, kanë nga një xhep me prerje të pjerrtë;

Në anën e majtë dhe në anën e djathtë, në lartësinë mbi gjunjë, janë të qepur dy xhepa në formë harmonike me

kapakë, të cilët mbërthehen me ngjitëse.

KAPELA

-Kapela duhet të jetë dok, blu e errët, e qepur me pe blu të errët;

-Materialet ndihmëse që duhen të përdoren për prodhimin e artikullit “kapelë” janë:

-dok, blu e errët;

-penj qepje, me ngjyrën e dokut;

-stema e kapelës.

6.KËPUCË VERORE



Këpucët janë të punuara prej lëkure me rezistencë në lagështi, dhe me trashësi prej 1,8–2,0mm dhe përbëhet prej pjesës së përparme, pjesës së prapme, qafës, me gjuhëz të mbyllur të cilët janë të përbëra nga dy shtresa të stepit, pjesës së poshtme dhe gjonit.

Pjesa e përparme është e punuar prej shtresës së lëkurës me shtresë të përforcuar termo.

Qafa, përkatësisht pjesa e përparme e këpucës është e punuar me astarë të lëkurës.

Në lartësinë prej 5cm nga pjesa e poshtme e këpucës janë të përforcuar skajet nga nyja me lëkurë të fortë ose me material tjetër ndërmjet astarit dhe fytyrës, ndërsa pjesa e sipërme e qafës, rreth nyjës në tërësi ndërmjet fytyrës dhe astarit me përforcues.

Shtresa e tabanit është formë anatomike.

7.KËPUCË DIMËRORE



Këpucët janë të punuara prej lëkure me rezistencë në lagështi, dhe me trashësi prej 1,8–2,0mm dhe përbëhet prej pjesës së përparme, pjesës së prapme, qafës, me gjuhëz të mbyllur të cilët janë të përbëra nga dy shtresa të stepit, pjesës së poshtme dhe gjonit.

Pjesa e përparme është e punuar prej shtresës së lëkurës me shtresë të përforcuar termo.

Qafa, përkatësisht pjesa e përparme e këpucës është e punuar me astarë të lëkurës.

Në lartësinë prej 5cm nga pjesa e poshtme e këpucës janë të përforcuar skajet nga nyja me lëkurë të fortë ose me material tjetër ndërmjet astarit dhe fytyrës, ndërsa pjesa e sipërme e qafës, rreth nyjës në tërësi ndërmjet fytyrës dhe astarit me përforcues.

Shtresa e tabanit është formë anatomike.

8. RRIP PANTALLONASH

Ripi për pantallona është i punuar prej lëkurës së zezë, të gjerësisë 3cm dhe me togës metalike.

9 .BLUZË ME MËNGË TË GJATA

Bluza me mëngë të gjata duhet të jetë pambuk, ngjyrë blu e errët, e qepur me pe blu të errët.

